

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2508/2016 të datës 23.11.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Besim Susuri, të akuzuarit dhe dëmtuarës A. M. nga Prizreni, me datë 07.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**B. M.** nga i ati U. dhe e ëma E. e lindur M., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, elektrikist, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 01.10.2016 rreth orës 21:30 minuta, në Prizren rrugën ... nën ndikimin e alkoolit, për shkak të problemeve familjare në mesë tij dhe dëmtuarës – bashkëshortes A. M., fillimisht bërtet, i thyen gjësendet dhe pastaj e sulmon fizikisht të dëmtuarën e godet me grushte në kokë, e kap për krahu, tërheq zvarrë dhe godet me shqelma, me ç'rast shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gjak mbledhje nën lëkurore të anës së majtë të nën nofullës së poshtme të fytyrës, të cilat lëndime kanë karakter të lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

#### **Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike – është pa punë, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarit.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 150 par.1 të LESP.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/IL.nr.2508/2016 të datës 23.11.2016, kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 01.10.2016 rreth orës 21:30 minuta, në Prizren rrugën ..., për shkak të raporteve jo të mira në mesë të akuzuarit B. M. dhe bashkëshortes, i akuzuari vjen në shtëpi në gjendje të dehur, fillimisht fjalosën, i thyen gjësendet dhe me pas e sulmon fizikisht të dëmtuarën A. M., e godet me grushte në kokë, kap për krahu dhe tërheq zvarrë duke goditur me shqelma, me ç'rast i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gjak mbledhje nën lëkurore të anës së majtë të nën nofullës së poshtme të fytyrës, të cilat lëndime kanë karakter të lëndimit të lehtë trupor me pasojë të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar ku i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndimi i lehtë trupor, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo gjykata sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, për veprën penale e cila i vihet në barrë e cila mbështetet në fakte dhe prova materiale, të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari është njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në shqiptim të aktgjykimit duke e vërtetuar përgjegjësinë penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, rrethanat familjare, gjendja ekonomike, që do të thotë është mbajtës i familjes, pendimi për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj të akuzuarit i shqipton dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprime të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2591/2016 të datës 07.11.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Teuta Spahiu**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.